


Tregtia e jashtme e mallrave

Maj 2019

Tiranë, më 17 Qershor 2019: Në Maj 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 28 mld lekë, duke u ulur me 8,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe rritur me 3,5 %, në krahasim me Prill 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 59 mld lekë, duke u rritur me 3,8 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 2,9 %, në krahasim me Prill 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 31 mld lekë, duke u rritur me 17,4 %, krahasuar me Maj 2018 dhe me 2,4 %, në krahasim me Prill 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Në pesëmujorin e parë të vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 127 mld lekë, duke u ulur me 3,6 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 264 mld lekë, duke u rritur me 3,4 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 137 mld lekë, duke u rritur me 10,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Ulja vjetore e eksporteve prej 8,2 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” dhe “Tekstile dhe këpucë” me -2,5 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +0,7 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Maj 2019



Eksportet, gjatë këtij pesëmuajori janë ulur me -3,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,6 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 3,8 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +3,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +0,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,6 pikë përqindje, etj.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Maj 2019



Si pesëmujor, importet janë rritur me 3,4 %, krahasuar me pesëmujorin e parë 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,2 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,5 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Maj 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Maj 2018 janë: Kosova (13,6 %), Gjermania (16,9 %), dhe Kina (140,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-1,3 %), Spanja (-27,4 %) dhe Greqia (-2,2 %).

Gjatë këtij pesërmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (40,1 %), Gjermani (0,5 %), dhe Maqedonia e Veriut (7,8 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-1,1 %), Spanja (-25,8 %) dhe Greqi (-7,8 %).

Në muajin Maj 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Maj 2018 janë: Kina (18,7 %), Turqia (96,1 %), dhe Greqia (25,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-12,6%), Spanja (-43,1 %) dhe Maqedonia e Veriut (-11,2 %).

Gjatë këtij pesëmuajori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (24,8 %), Greqia (15,9 %) dhe Turqia (12,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-7,9 %), Gjermania (-14,7 %) dhe Spanja (-11,6 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Maj 2019 (%)



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 63,2 %, të gjithë tregtisë. Në Maj 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,8 %), Kina (7,7 %), Greqia (7,6 %) dhe Turqia (6,5 %).

Shkëmbimet tregtare, për pesëmuajorin e parë 2018, me vendet e BE zënë 65,1 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Maj 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,5 %), Greqia (7,3 %), Kina (7,0 %) dhe Gjermania (6,1 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	Janar - Maj 17	111	16,8	239	5,0	-128	46,5
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	Janar - Maj 18	131	18,5	255	7,0	-124	51,5
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,2	59	3,8	-31	47,0
	Janar - Maj 19	127	-3,6	264	3,4	-137	48,0

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Maj 2018	Maj 2019	Jan.- Maj. 2018	Jan.- Maj 2019	Maj 2018	Maj 2019	Jan.- Maj. 2018	Jan.- Maj 2019
Vendet e BE-së	22.492	20.504	101.768	97.055	35.580	34.252	159.348	157.207
Austri	177	100	767	894	752	578	2.809	3.051
Mbretëri e Bashkuar	123	60	362	330	606	498	2.358	2.103
Gjermani	1.091	1.276	5.848	5.877	4.060	4.180	21.114	18.007
Greqi	1.259	1.231	5.722	5.275	4.236	5.331	20.111	23.314
Itali	13.353	13.186	63.868	63.162	17.456	15.256	73.635	67.853
Spanjë	2.619	1.901	10.635	7.887	1.681	956	5.277	4.665
Kroaci	105	94	360	461	469	678	2.210	2.737
Të tjera të BE-së	3.765	2.655	14.207	13.168	6.319	6.774	31.833	35.478
Kinë	300	721	3.104	2.721	5.046	5.988	19.745	24.649
Kosovë	2.735	3.107	8.612	12.064	781	840	3.158	3.020
Maqedonia e Veriut	972	756	3.314	3.571	937	832	3.545	3.514
Rusi	1	12	11	70	1.261	569	4.485	4.719
SHBA	250	244	1.941	1.766	580	1.148	3.882	4.531
Turqi	181	87	626	882	4.099	5.578	20.473	22.942
Ukrainë	18	6	94	94	201	126	882	1.189
Zvicër	446	47	2.190	335	717	1.458	4.365	7.143
Të tjera	2.771	2.199	9.426	8.153	7.571	8.123	35.481	35.212
Gjithsej	30.166	27.683	131.413	126.713	56.773	58.914	255.367	264.127

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup - mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Maj 2018	Maj 2019	Jan.- Maj. 2018	Jan.- Maj 2019	Maj 2018	Maj 2019	Jan.- Maj. 2018	Jan.- Maj 2019
Gjithsej	30.166	27.683	131.413	126.713	56.773	58.914	255.367	264.127
Ushqime. pije. duhan	3.786	3.736	12.771	14.342	9.488	9.195	42.999	43.258
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	6.141	4.928	25.997	19.800	5.286	7.038	26.240	33.610
Produkte kimike dhe plastike	631	671	2.318	2.962	7.909	7.686	35.599	35.249
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	318	235	1.250	1.073	1.934	1.910	8.126	7.776
Prodhime druri dhe letre	748	825	3.611	3.943	2.522	2.400	9.710	9.837
Tekstile dhe këpucë	11.198	10.429	52.640	51.651	8.121	8.506	36.102	36.154
Materiale ndërtimi dhe metale	5.141	4.379	22.515	20.381	7.041	7.978	30.099	33.142
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	1.446	1.647	6.787	8.854	12.262	11.948	56.708	55.535
Të tjera	758	833	3.525	3.707	2.211	2.253	9.784	9.567

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup - mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	63.868	63.162	8.612	12.064	10.635	7.887	5.848	5.877
Ushqim, pije duhan	3.208	3.338	1.097	1.521	448	553	523	509
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	1.440	2.884	1.223	2.925	8.886	6.286	1.078	508
Produkte kimike dhe plastike	640	796	509	804	21	14	12	29
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	955	856	1	4	100	100	3	6
Prodhime druri dhe letre	2.529	2.765	187	322	3	3	59	60
Tekstile dhe këpucë	40.978	40.415	49	32	1.069	823	3.109	3.085
Materiale ndërtimi dhe metale	8.194	6.192	4.741	5.516	95	102	287	675
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	4.229	4.285	302	302	4	3	528	658
Të tjera	1.695	1.631	502	640	9	2	250	346

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup - mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	73.635	67.853	19.745	24.649	20.473	22.942	20.111	23.314
Ushqim, pije duhan	7.323	7.791	243	349	2.458	2.330	6.352	6.183
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	6.007	3.053	3	1	352	358	2.550	6.135
Produkte kimike dhe plastike	7.375	7.522	1.940	2.155	3.053	3.086	3.104	3.116
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	6.236	6.236	297	325	140	103	37	16
Prodhime druri dhe letre	2.990	2.790	415	402	1.203	1.267	1.219	1.297
Tekstile dhe këpucë	18.238	17.373	3.937	4.597	6.434	7.113	1.585	1.545
Materiale ndërtimi dhe metale	8.834	8.039	2.469	4.174	2.878	4.844	3.454	3.293
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	14.072	12.979	8.533	10.418	3.011	2.988	1.086	1.078
Të tjera	2.562	2.070	1.908	2.228	946	852	724	651

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri